



N.SH. "Intersat"
Tomor Halilaj
Pronar
OK "N.SH. "Intersat"
Rr/Skenderbeu p.n.
Drenas

VENDIMI: LIC/KPM-2013/17
Ref: 1302/377/KPM/ni

VENDIM

lidhur me aplikacionin për licencë të operatorit kabllor, N.SH. "Intersat"-Drenas

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
1. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores CIMC 2007/04, operatorët aktivë kabllor kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
2. Kandidati për operator kabllor N.SH. "Intersat", ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operator kabllor më datën 30 dhjetor 2012.

Arsyetim

3. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
4. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja*".

5. Në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullës CIMC 2007/04 operatori kabllor N.SH. "Intersat", ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor.
6. Me anë të Rregullores për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor. Prandaj KPM, vlerëson se një operator kabllor mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve nëse ai posedon marrëveshjet valide për ritransmetimin e atyre programeve.
7. Operatori kabllorë N.SH. "Intersat", do të ketë të drejtë të bart në pakon e tij, vetëm programet televizive për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.
8. Nëse, pas marrjes së licencës, operatori kabllor N.SH. "Intersat" siguron marrëveshje shtesë apo të reja për ritransmetimin e programeve në rrjetin kabllor, KPM, pas pranimit të kontratave të reja, do të zgjerojë listën e programeve të kandidatit. Operatori kabllor N.SH. "Intersat" obligohet t'i ofrojë KPM-së, të gjitha marrëveshjet e reja, sapo t'i ketë siguruar.
9. KPM, vlerëson se N.SH. "Intersat" ka paraqitur aplikacionin në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me rregulloren për Marrjen e Licencës së KPM-së (CIMC 2009/02).
10. Prandaj, KPM-së vlerëson se në bazë të nenit 6 të Rregullores CIMC 2007/04 operatori kabllor N.SH. "Intersat" ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

Vendim


11. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon se N.SH. "Intersat" ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve kabllore përmes sistemit kabllor në komunën e Drenasit.
12. Komisioni i Pavarur për Media, vendos që operatorit kabllor N.SH. "Intersat", i cili planifikon të operojë në Drenas, t'i lëshoj licencën e KPM-së, për të ofruar përmes rrjetit kabllor, shërbime të programeve, për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve.
13. Në bazë të Nenit 3.2 të Rregullores për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca e operatorit kabllor N.SH. "Intersat" do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.
14. Në pajtueshmëri me Nenin 5.1 të Rregullores për nivelin dhe mënyrën e pagesës së taksës së licencës për shërbimet mediave audio-vizuale (KKPM-2010/02), çdo Ofrues i Shërbimeve Programore duhet të paguajë taksë vjetore. Niveli i taksës

vjetore për licencë të Operatorëve Kabllorë, është i përcaktuar me Nenin 4.2.1. të rregullores së lartpërmendur në këtë paragraf.

15. Në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2010/02 përkatësisht me nenin 5.2 të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve programore “N.SH. “Intersat” duhet ta paguajë taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të vendimit për licencim.

Lëshimi i Vendimit

16. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media.


Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media.



15.02.2013
data



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Arben Fetoshi
Drejtore
Radio Kosova
R003b
Rr/ Nëna Terezë p.n.
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2013/14
Ref:1302/374/KPM/ni

VENDIM

*në lidhje me kërkesën e Radio Kosovës për ndryshimin e emrit në **Radio Kosova 1**
(Radio Kosova -Programi i Parë)*

Fakte

1. Radio Kosova, është Transmetues Publik me mbulim nacional me seli në Prishtinë, e cila është pajisur me licencë afatgjatë të Komisionit të Pavarur për Media (KPM), më 28 gusht 2009.
2. KPM, me datën 11 janar 2013, ka pranuar kërkesën nga drejtore i Radio Kosovës z. Arben Fetoshi për ndryshimin e emrit nga Radio Kosova në **Radio Kosova 1**.

Arsyetim

3. Kërkesa për ndryshimin e emrit të Radio Kosovës në **Radio Kosova 1**, është bazuar sipas modelit të transmetuesve publik evropian dhe i bazuar gjithashtu në Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës, i cili e përcakton përbërjen e RTK-së me dy kanale të Radio Kosovës.
4. Kërkesa për ndryshimin e emrit të Radio Kosovës, nuk paraqet asnjë ndryshim tjetër në Pakon e Licencës së KPM-së për këtë radio stacion.
5. Emri i propozuar **Radio Kosova 1**, për t'u identifikuar në të ardhmen si radio stacion në Republikën e Kosovës, nuk është i ngjashëm me asnjë nga emrat e subjekteve transmetuese të licencuara nga KPM, që operojnë në Republikën e


Kosovës, dhe si i tillë nuk paraqet ndonjë problem lidhur me identifikimin e radio stacionit nga ana e dëgjuesve.

Vendim

6. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon që ndryshimi i emrit të Radio Kosovës në **Radio Kosova 1**, nuk paraqet ndryshime të tjera të licencës.
7. Komisioni i Pavarur për Media, merr vendim që Radio Kosovës t'i lejohej ndryshimi i emrit në **Radio Kosova 1**.

Lëshimi i Vendimit

8. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media.


Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



15.02.2013
datë